Vendim nr. 88, datë 06.10.2026

(V- 88/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 06.10.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (D) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **DASHMIRA ZARO**

SUBJEKT I INTERESUAR:

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Denisa Skënderaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-4801, datë 24.12.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit.
Detyrimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për gjykimin me përparësi të çështjes nr. 21246-04097-30-2023.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses Dashmira Zaro (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është trashëgimtare ligjore e të ndjerit Th.Z., i cili, në cilësinë e trashëgimtarit të subjektit të shpronësuar J.M., me vendimin nr. 23-2013-1436, datë 26.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është rivendosur në afat për t'iu drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*AKKP*) për njohjen dhe kthimin e pronës subjektit të shpronësuar. Pasi AKKP-ja e ka njoftuar për nevojën e saktësimit gjyqësor të kufijve të pronës, Th.Z. i është drejtuar gjykatës me kërkesë për vërtetimin e faktit juridik. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 384, datë 23.09.2014, ka pranuar kërkesën, duke saktësuar kufijtë e pronës për sipërfaqen e përgjithshme të tokës bujqësore.

2. Në datën 28.03.2019, pas kalimit të afatit 3-vjeçar të përcaktuar në nenin 34 të ligjit nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" *(ligji nr. 133/2015),* në kushtet kur kërkesa e paraqitur për shqyrtim administrativ që në vitin 2013 nuk ishte përfunduar me vendim nga AKKP-ja dhe, në vijim, nga Agjencia e Trajtimit të Pronave *(ATP),* Th.Z. i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar njohjen e së drejtës së pronësisë së subjektit të shpronësuar J.M. për sipërfaqen 158.000 m^2 tokë bujqësore, detyrimin e ATP-së për pagimin e shumës 22.921.600 lekë brenda 10 vjetëve, me këste vjetore, si dhe pagimin e kësteve të prapambetura dhe kamatëvonesave brenda 30 ditëve nga marrja formë të prerë të vendimit. Gjatë gjykimit në shkallë të parë, Th.Z. ka ndërruar jetë dhe është bërë zëvendësimi procedural me trashëgimtarët Dashmira Zaro, J.Z. dhe E.Z.

3. Gjatë procesit gjyqësor, një nga trashëgimtarët paditës, J.Z., ka kërkuar konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit në shkallë të parë. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 20-2022-171/04, datë 23.03.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në vijim, J.Z. i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, për të cilin Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 134, datë 12.10.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me vendimin nr. 155 (21-2023-768), datë 16.05.2023, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi paditësit kanë ushtruar ankim, mbi bazën e të cilit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është regjistruar çështja nr. 21246-04097-30-2023, datë 19.10.2023.

5. Në datën 30.11.2023, kërkuesja Dashmira Zaro i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në apel dhe përshpejtimin e

shqyrtimit të çështjes. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-312, datë 17.01.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se nuk konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm, pasi nga momenti i regjistrimit të çështjes në gjykatën e apelit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës kishin kaluar vetëm 41 ditë, ndërkohë që afati ligjor i gjykimit në apel ishte 2 vjet, sipas nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Në datën 20.02.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, për të cilin Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 99, datë 10.05.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke vlerësuar se nuk ndodhej përpara një situate të tejzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit.

6. Në datën 22.10.2025, kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë, duke kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në apel dhe marrjen e masave për përshpejtimin e tij. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi është njohur edhe me mendimin me shkrim të gjyqtares relatore në gjykatën e apelit, me vendimin nr. 00-2025-4801, datë 24.12.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sipas atij kolegji, ndonëse ishte tejkaluar afati 2-vjeçar i gjykimit në apel, i parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "b", i KPC-së, vonesa ishte pasojë e pamundësisë objektive për shqyrtimin e çështjes, për shkak të ngarkesës së jashtëzakonshme të çështjeve dhe numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve në gjykatën e apelit, situatë që tejkalonte rastin individual dhe shfaqte një problematikë që përfshinte sistemin gjyqësor në tërësi. Në vlerësimin e tij, Kolegji Civil ka mbajtur në konsideratë ngarkesën individuale të gjyqtares relatore, si dhe atë në raport me gjyqtarët e tjerë të gjykatës së apelit. Ai ka çmuar se mosgjykimi i çështjes së kërkueses nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime ose qëndrime abuzive të gjyqtares relatore, e cila ndiqte radhën e vjetërsisë së çështjeve. Gjithashtu, sipas mendimit të saj me shkrim, pas rrëzimit të kërkesës së mëparshme për përshpejtim, paditësit nuk kishin paraqitur ndonjë kërkesë tjetër.

7. Në datën 01.04.2026, përmes shërbimit postar, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit të pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Ky ankim është regjistruar në datën 02.04.2026. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 02.06.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi:

8.1. Çështja ka qenë në shqyrtim administrativ pranë AKKP-së dhe në vijim pranë ATP-së që prej datës 19.08.2013, pa u përfunduar për më shumë se pesë vjet e gjysmë, deri më 23.02.2019. Kjo kohëzgjatje përbën shkak veçanërisht të rëndë për përshpejtimin e gjykimit sipas kreut II, pikave 4, 5 dhe 6 të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit" (*vendimi i KLGJ-së nr. 78/2019*). Nëse ATP-ja do të kishte dalë me vendim brenda afatit ligjor, pra datës 23.02.2019, subjektit të shpronësuar do t'i kishte lindur e drejta e ankimit drejtpërdrejt në gjykatën e apelit sipas ligjit nr. 133/2015. Mosmarrja e një vendimi nga organi administrativ ka bërë të nevojshme ndjekjen e rrugës gjyqësore, duke sjellë zvarritjen e mëtejshme të procesit të njohjes dhe të kompensimit të pronës.

8.2. Gjykimi në shkallë të parë ka zgjatur mbi katër vjet, nga data 28.03.2019 deri më 16.05.2023, çka përbën një tjetër shkak për përshpejtimin e gjykimit në apel sipas vendimit të KLGJ-së nr. 78/2019. Edhe pse Gjykata e Lartë ka konstatuar tejkalimin e afatit të parashikuar nga neni 399/2 i KPC-së, ajo e ka rrëzuar kërkesën, duke e justifikuar vonesën me ngarkesën e lartë të çështjeve, çka është konsideruar e pabazuar nga Gjykata në jurisprudencën e saj. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush standardin e arsyetimit, pasi nuk vlerëson natyrën e mosmarrëveshjes, kohëzgjatjen e procedurës administrative dhe të gjykimit në shkallë të parë, si dhe rrezikun që sjell mungesa e përshpejtimit të gjykimit për shkak të moshës 79-vjeçare të kërkueses. Po kështu, edhe pse Gjykata e Lartë u referohet kritereve objektive dhe transparente për përcaktimin e radhës së gjykimit, ajo nuk referon çështje në rrethana të ngjashme që duhet të shqyrtohen përpara çështjes së kërkueses.

9. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** ka prapësuar se:

9.1. Në analizë të kritereve të evidentuara nga Gjykata për vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, sikundër ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, vonesa në gjykimin e çështjes në apel nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive ose qëndrime abuzive të gjyqtares relatore, e cila ndjek radhën e vjetërsisë sipas datës së regjistrimit të çështjeve. Sikurse ka relatuar ajo gjyqtare në mendimin e saj me shkrim, pas rrëzimit të kërkesës së mëparshme për përshpejtim, kërkuesja nuk ka paraqitur kërkesë tjetër për t'u vlerësuar prej saj. Vonesa është shkaktuar nga ngarkesa e jashtëzakonshme dhe numri i pakët i gjyqtarëve. Për më tepër, gjatë vitit 2025 gjyqtarja relatore ka ushtruar edhe detyrën e anëtares së Këshillit të Emërimeve në

Drejtësi, ku ka qenë relatore për vakancën në Gjykatën Kushtetuese, detyra që kanë kërkuar angazhim të konsiderueshëm.

9.2. Në mungesë të veprimeve që përbëjnë administrim të parregullt gjyqësor ose neglizhencë të gjyqtarit, nuk mund të konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm, për sa kohë vonesa lidhet me pamundësinë objektive të gjykatës për shkak të ngarkesës së lartë të shkaktuar nga reforma në drejtësi. Në këto kushte, përshpejtimi i shqyrtimit të çështjes së kërkueses do të cenonte barazinë në radhën e trajtimit të çështjeve të ngjashme.

9.3. Për sa i përket rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja, mosha e saj nuk përbën shkak që imponon përshpejtimin e gjykimit. Ky argument i kërkueses mbështetet në premisa të gabuara juridike, pasi përshpejtimi nuk garanton një vendim në favor të kërkueses dhe as përfundimin e procesit, duke pasur parasysh mundësinë e ushtrimit të rekursit në Gjykatën e Lartë. Për më tepër, të drejtat pasurore nuk shuhen me vdekjen e subjektit, por janë të transmetueshme tek trashëgimtarët, ndaj nuk ka rrezik për humbjen e vet së drejtës materiale. Kërkuesja nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e saj, natyra dhe rëndësia e të cilave justifikon trajtimin me përparësi të çështjes, ndërkohë që interesat e saj lidhen me të drejtën e pronës, që janë interesa vetjakë, por jo jetësorë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

10. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë, si dhe jurisprudencën e konsoliduar të saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae, shterimi i mjeteve juridike efektive* dhe *ratione temporis* në rastin konkret janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme dhe as nuk evidentohen rrethana faktike që mund ta çojnë Gjykatën në një qëndrim të ndryshëm në këtë drejtim.

12. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor,* për shkak të *mosgjykimit të çështjes së saj brenda një afati të arsyeshëm* nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Ky pretendim, për nga natyra dhe argumentet e parashtruara në mbështetje të tij, hyn në juridiksionin kushtetues, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ndaj në vijim do të analizohet bazueshmëria e tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

13. Kërkuesja ka pretenduar se kohëzgjatja e procedurës administrative pranë AKPP-së dhe ATP-së, për më shumë se pesë vjet e gjysmë, si dhe ajo e gjykimit të çështjes në shkallë të parë, për mbi katër vjet, përbëjnë shkaqe që justifikojnë përshpejtimin e gjykimit të çështjes në apel, sipas vendimit të KLGJ-së nr. 78/2019. Ajo ka theksuar se, për shkak të mosmarrjes së vendimit nga organi administrativ brenda afatit ligjor, është detyruar t'i drejtohet gjykatës, çka ka sjellë zvarritjen e mëtejshme të procesit të njohjes dhe të kompensimit të pronës. Kërkuesja ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, me të cilin, ndonëse është konstatuar tejkalimi i afatit të parashikuar nga neni 399/2 i KPC-së, kërkesa e saj është rrëzuar. Sipas kërkueses, ky vendim nuk përmbush standardin e arsyetimit, pasi nuk vlerëson natyrën e mosmarrëveshjes, kohëzgjatjen e procedurave të mëparshme dhe rrezikun që sjell mungesa e përshpejtimit të gjykimit për shkak të moshës së saj 79-vjeçare.

14. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se vonesa në gjykimin e çështjes në apel nuk është shkaktuar nga neglizhenca ose nga qëndrime abuzive të gjyqtares relatore, por nga ngarkesa e jashtëzakonshme dhe numri i pakët i gjyqtarëve në atë gjykatë, si pasojë e reformës në drejtësi. Sipas këtij subjekti, mosha e kërkueses nuk justifikon, në vetvete, përshpejtimin e gjykimit në apel, ndërkohë që kjo nuk garanton as përfundimin e procesit, pasi vendimi i gjykatës së apelit mund të kundërshtohet më tej në Gjykatën e Lartë. Po kështu, të drejtat pasurore janë të transmetueshme tek trashëgimtarët, ndaj nuk ka rrezik për humbjen e vet së drejtës materiale. Për rrjedhojë, sipas Avokaturës së Shtetit, kërkuesja nuk ka provuar rrezikun për interesat e saj, natyra dhe rëndësia e të cilave të justifikojnë trajtimin me përparësi të çështjes, ndërkohë që interesat e saj lidhen me të drejtën e pronës, të cilat janë vetjakë, por jo jetësorë.

15. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e

përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se procesi gjyqësor, për të cilin është pretenduar cenimi i së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ka filluar në datën 28.03.2019, me padinë e paraqitur nga trashëgimlënësi i kërkueses, Th.Z., për njohjen e së drejtës së pronësisë të subjektit të shpronësuar J.M. për sipërfaqen 158.000 m^2 tokë bujqësore dhe detyrimin e ATP-së për kompensimin e saj. Pas vdekjes së paditësit, gjatë gjykimit në shkallë të parë, procesi ka vijuar nga trashëgimtarët e tij, përfshirë kërkuesen. Gjatë këtij gjykimi, një prej trashëgimtarëve, J.Z., ka kërkuar konstatimin e tejzgjatjes së procesit, kërkesë e cila është rrëzuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin e datës 23.03.2022. Në vijim, Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 12.10.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

17. Gjykimi në shkallë të parë ka përfunduar me vendimin e datës 16.05.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me të cilin është rrëzuar padia. Mbi ankimin e paditësve çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në datën 19.10.2023. Kërkesa e paraqitur nga kërkuesja në datën 30.11.2023, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes në apel është rrëzuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin e datës 17.01.2024, ndërsa për ankimin kushtetues individual të kërkueses, Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 10.05.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

18. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se në datën 30.05.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) me aplikimin nr. 16770/24 (*Zaro v. Albania*). Megjithatë, nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues dhe informacioni i disponueshëm në faqen zyrtare të GJEDNJ-së nuk rezultojnë të dhëna për procesin gjyqësor me të cilin lidhen shkeljet e pretenduara të të drejtave konventore dhe fazën e shqyrtimit të këtij aplikimi.

19. Ndërkohë, në datën 22.10.2025, kërkuesja i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes në apel. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 24.12.2025, ka rrëzuar kërkesën, duke vlerësuar se, edhe pse ishte tejkaluar afati 2-vjeçar i shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së, vonesa ishte shkaktuar nga ngarkesa e jashtëzakonshme e çështjeve dhe numri i pakët i gjyqtarëve në detyrë, si pasojë e reformës në drejtësi dhe jo nga mungesa e vullnetit të gjyqtares relatore.

20. Gjykata vëren se, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, afati i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit civil në gjykatën e apelit është dy vjet. Sipas pikës 2 të kësaj dispozite, palët mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, sipas nenit 399/6, pika 1, të KPC-së, edhe pa kaluar ky afat, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen.

21. Gjykata konstaton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në datën 19.10.2023. Sipas informacionit të dërguar nga kjo gjykatë me shkresat e datave 30.04.2026 dhe 24.09.2026, në përgjigje të kërkesave të Gjykatës, rezulton se deri në datën 22.09.2026 çështja nuk ishte planifikuar ende për gjykim.

22. Në rrethanat e mësipërme, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor, i filluar në datën 28.03.2019, vijon prej më shumë se shtatë vjetësh, ndërsa gjykimi në gjykatën e apelit, i regjistruar në datën 19.10.2023, prej afro tre vjetësh, duke tejkaluar kështu afatin e parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së. Gjykata vlerëson se, ndonëse tejkalimi i afatit ligjor nuk nënkupton automatikisht shkeljen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ai përbën një tregues të rëndësishëm që duhet vlerësuar në raport me rrethanat konkrete të çështjes. Për rrjedhojë, duke mbajtur parasysh kohëzgjatjen e gjykimit në gjykatën e apelit dhe atë tërësore të procesit gjyqësor, si dhe rrethanën që këtij procesi i ka paraprirë një procedurë administrative disavjeçare për të njëjtën mosmarrëveshje, Gjykata do të vlerësojë nëse kohëzgjatja e gjykimit në apel është e arsyeshme, sipas standardeve të jurisprudencës kushtetuese.

23. Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes konkrete dhe të kritereve që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi *(shih vendimet nr. 64, datë 02.06.2026; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese).*

24. Për sa u përket kritereve që lidhen me *sjelljen e kërkueses* dhe *kompleksitetin e çështjes*, Gjykata vëren se nuk rezultojnë rrethana që të tregojnë se kërkuesja ka shkaktuar ose ka ndikuar në vonesën e gjykimit të çështjes në apel. Përkundrazi, ajo ka përdorur mjetet juridike në dispozicion për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, duke iu drejtuar Gjykatës së Lartë sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Po kështu, ndonëse mosmarrëveshja lidhet me njohjen dhe kompensimin e pronës, nuk rezulton që vonesa në planifikimin e çështjes për gjykim në apel të jetë shkaktuar nga kompleksiteti i saj. Edhe Gjykata e Lartë, në vendimin e kundërshtuar, nuk ka identifikuar si shkaqe të vonesës sjelljen e kërkueses ose kompleksitetin e çështjes. Për

rrjedhojë, analiza e Gjykatës do të përqendrohet në sjelljen e autoriteteve dhe rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja për shkak të vonesës së gjykimit të çështjes së saj.

25. Në lidhje me *sjelljen e autoriteteve,* Gjykata ka theksuar se shteti ka detyrimin pozitiv të organizojë sistemin gjyqësor në mënyrë të tillë që gjykatat të jenë në gjendje të garantojnë të drejtën e çdo individi për një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm. Ajo ka pranuar se reforma në drejtësi dhe procesi i rivlerësimit kalimtar, pa mohuar nevojën, rëndësinë dhe përfitimet, kanë krijuar pasoja të ndjeshme në funksionimin e sistemit gjyqësor, veçanërisht për shkak të vakancave dhe ngarkesës së krijuar në gjykata. Megjithatë, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se këto rrethana, ndonëse mund të merren në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm të çështjes, nuk mund të shërbejnë, në vetvete, si justifikim i mjaftueshëm për vonesa të tejzgjatura, aq më tepër kur ato kthehen në problem strukturor të organizimit të gjyqësorit. Në raste të tilla, shteti, përmes autoriteteve përgjegjëse, duhet të ndërhyjë me masa efektive ligjore, organizative dhe institucionale për të garantuar realisht të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 64, datë 02.06.2026; nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në vendimin e kundërshtuar, e ka pranuar tejkalimin e afatit ligjor 2-vjeçar për gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit, por ka vlerësuar se vonesa nuk i atribuohet sjelljes subjektive të gjyqtares relatore, por pamundësisë objektive të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për shkak të ngarkesës së lartë të çështjeve dhe numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve të saj. Gjykata, duke mbajtur parasysh edhe qëndrimin e saj në çështje të tjera të kësaj natyre, rithekson se një arsyetim i tillë, i mbështetur vetëm në vështirësitë strukturore të sistemit gjyqësor, nuk pajtohet me standardin kushtetues dhe konventor të konsoliduar për të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Standardi i nenit 42 të Kushtetutës nuk kufizohet vetëm në mungesën e fajit subjektiv të gjyqtarit relator ose të gjykatës kompetente, por kërkon të vlerësohet nëse shteti, përmes autoriteteve përgjegjëse për organizimin, administrimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë, ka marrë masat e nevojshme ligjore, institucionale dhe organizative për të garantuar shqyrtimin e çështjeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, fakti se vonesa lidhet me shkaqe strukturore nuk e përjashton përgjegjësinë kushtetuese të autoriteteve publike për garantimin efektiv të kësaj të drejte dhe nuk mund të shërbejë si bazë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm (*shih vendimin nr. 64, datë 02.06.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në lidhje me kriterin *e rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja,* në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë" kërkojnë trajtim me shpejtësi e përparësi, ku si të tilla janë, ndër të tjera, çështjet që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe

pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuesit verifikohet rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka konstatuar shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm edhe në rastet që nuk kërkonin domosdoshmërisht trajtim me përparësi, duke mbajtur parasysh kohëzgjatjen e konsiderueshme të procesit gjyqësor dhe rëndësinë e të drejtave të palëve, si në rastin e mosmarrëveshjeve për të drejtën e pronës të lidhura me procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave *(shih vendimin nr. 46, datë 03.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se zgjidhja përfundimtare e problemeve që kanë të bëjnë me procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave, si çështje jo vetëm me interes publik, por, para së gjithash, me natyrë kushtetuese, përbën prioritet, pasi e drejta e pronës përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit (*shih vendimin nr.1, datë 06.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po ashtu, duke iu referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata është shprehur se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile, edhe kur çështja nuk kërkon ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtën, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm, pa qenë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale (*shih vendimin nr. 54, datë 09.10.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vlerësimi i rëndësisë së interesave të kërkueses nuk mund të shkëputet nga kohëzgjatja e procedurës administrative që i ka paraprirë procesit gjyqësor. Në këtë drejtim, ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", sikundër dhe ai në vijim nr. 133/2015, kishin parashikuar shqyrtimin fillestar të kërkesave për njohjen dhe kompensimin e pronave nga organi administrativ kompetent, duke synuar përfundimin e procesit brenda afateve të caktuara. Ky organizim ligjor synonte trajtimin e kërkesave fillimisht në rrugë administrative, duke shmangur, për aq sa ishte e mundur, kalimin e mosmarrëveshjeve në gjykatë dhe ngarkesën e mëtejshme të sistemit gjyqësor. Në këtë kuadër, neni 34 i ligjit nr. 133/2015, sipas formulimit në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë nga trashëgimlënësi i kërkueses, kishte përcaktuar një afat 3-vjeçar për përfundimin e shqyrtimit të kërkesave të patrajtuara, pas përfundimit të të cilit, në mungesë të vendimmarrjes nga ATP-ja, subjektet mund t'i drejtoheshin gjykatës së shkallës së parë. Ndërkohë, sipas nenit 29 të këtij ligji, kundër vendimit të ATP-së për njohjen e së drejtës mund të ushtrohej ankim drejtpërdrejt në gjykatën e apelit.

30. Gjykata vëren se në rastin konkret, sipas të dhënave të paraqitura, kërkesa e trashëgimlënësit të kërkueses ka qenë në shqyrtim administrativ që prej vitit 2013, pa u përfunduar me vendim brenda afatit ligjor, çka ka bërë të nevojshme ndjekjen e rrugës gjyqësore në gjykatën e

shkallës së parë, në vend të kundërshtimit të një vendimi të ATP-së drejtpërdrejt në gjykatën e apelit. Ndonëse kohëzgjatja e procedurës administrative nuk përfshihet, si e tillë, në llogaritjen e afatit të gjykimit sipas nenit 399/2 të KPC-së, ajo përbën një rrethanë me rëndësi për vlerësimin e kohës së përgjithshme gjatë së cilës kërkuesja dhe trashëgimlënësi i saj kanë pritur zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kjo merr rëndësi të veçantë duke pasur parasysh se procesi gjyqësor ka zgjatur mbi 7 vjet, pa përfunduar ende gjykimi në gjykatën e apelit, si dhe mundësinë e vijimit të tij në Gjykatën e Lartë. Në këtë kontekst, duke konsideruar edhe natyrën e mosmarrëveshjes, rëndësinë e interesit pasuror që kërkohet të mbrohet dhe moshën 79-vjeçare të kërkueses, Gjykata çmon se këto rrethana, të vlerësuara së bashku, i japin peshë të veçantë pasojave që sjell vonesa për interesat e saj në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes. Ndërkohë, fakti që të drejtat pasurore janë të transferueshme tek trashëgimtarët nuk e përjashton interesin e kërkueses për të marrë një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

31. Për sa më sipër, Gjykata, duke vlerësuar kohëzgjatjen e gjykimit në gjykatën e apelit dhe atë tërësore të procesit gjyqësor, periudhën e gjatë të shqyrtimit administrativ që i ka paraprirë atij, sjelljen e autoriteteve, natyrën e mosmarrëveshjes dhe rëndësinë e interesave të kërkueses, veçanërisht në raport me moshën e saj, çmon se rrethanat konkrete kërkonin trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Në këtë drejtim, Gjykata mban parasysh se respektimi i radhës kronologjike të gjykimit përbën, në parim, një kriter objektiv për administrimin e drejtë të ngarkesës gjyqësore dhe garantimin e barazisë ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Megjithatë, kjo rrethanë nuk mund të shërbejë si bazë e vetme për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës, pasi një qasje e tillë do ta bënte joefektiv mjetin e posaçëm procedural të parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së (*shih vendimin nr. 64, datë 02.06.2026 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, ngarkesa e gjykatës së apelit dhe vështirësitë organizative të sistemit gjyqësor nuk përbëjnë *per se* justifikim të mjaftueshëm për vonesën e konstatuar.

32. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i mbështetur kryesisht në pamundësinë objektive të gjykatës së apelit, nuk u ka dhënë peshën e duhur rrethanave të veçanta të çështjes dhe rëndësisë së interesave të kërkueses. Për këto arsye, Gjykata nuk e gjen të bazuar as prapësimin e Avokaturës së Shtetit se qëndrimi i Gjykatës së Lartë është në përputhje me kriteret e elaboruara në jurisprudencën kushtetuese në drejtim të vlerësimit për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor. Në këto kushte, Gjykata arrin në përfundimin se kërkueses i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ndaj vendimi nr. 00-2025-4801, datë 24.12.2025 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, për arsyet e mësipërme dhe duke mbajtur parasysh natyrën

vazhduese të shkeljes, Gjykata vlerëson se çështja e kërkueses duhet të shqyrtohet me përparësi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueses është e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-4801, datë 24.12.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në çështjen nr. 21246-04097-30-2023, datë 19.10.2023.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 06.10.2026

Shpallur më 29.10.2026